



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 45, Datë 29.03.2024

MBI

**FILMIN E PROCEDURES PËR SHQYRTIMIN E DRAFT “KONTRATËS PËR
DIFERENCË” (CFD) KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS TIP PËR
MBËSHTETJE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 14 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; si dhe neneve 19 dhe 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.03.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 823 prot., datë 26.03.2024, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e draft “Kontratës për Diferencë (CFD) Kushtet e Përgjithshme të kontratës TIP për Mbështetje”,

Konstatohet se:

- Enti Rregullator i Energjisë, mbështetur në nenin 14, pika 2 e ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” është autoriteti përgjegjës për miratimin e “Kushteve të përgjithshme të kontratës tip për mbështetje”.
- Referuar nenit 14 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” parashikon se : 1. Kontratat për mbështetje përfshijnë: a) kushtet e përgjithshme, të cilat përbëhen nga kushte dhe terma kontraktuale të standardizuar, që janë të ngjashëm me të gjitha projektet e krahasueshme. b) kushtet individuale, të cilat përbëhen nga kushte specifike të zbatueshme për projekte individuale dhe/ose zgjedhje midis opsioneve të disponueshme sipas kushteve të përgjithshme. 2. Kushtet e përgjithshme të kontratës tip për mbështetje miratohen nga Enti Rregullator i Energjisë. 3. Në një proces konkurrues, ministri mund të publikojë paraprakisht si pjesë të dokumenteve të procedurës konkurruese kushtet e përgjithshme dhe individuale të kontratës përkatëse për mbështetje. 4. Kontratat për mbështetje përgjithësisht kanë një kohëzgjatje prej 15 vjetësh.
- Në lidhje me përmbushjen e detyrimit që rrjedh nga dispozita e sipërcituar dhe mbështetur në “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, por dhe në zbatim të vendimit të bordit të ERE nr. 351/2023 “Për miratimin e kalendarit të masave të ERE për vitin 2023 në kudër të plotësimit të rekomandimeve të rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të

Energjisë miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë”, nëpërmjet konsulentit të kontraktuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), nëpërmjet postës elektronike (e-mail) të datës 19.12.2023, na ka vënë në dispozicion draft marrëveshjen për “ Kontratën për diferencë” në gjuhën Shqipe dhe Angleze.

- Nga vlerësimi paraprak i kushteve të përgjithshme të “Draft Kontratës për Diferencë” rezulton se marrëveshja përmban 24 klauzola dhe 6 shtojca të cilat parashikojnë, detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve nënshkruese nga njëra anë; (i) pala mbështetëse në cilësinë e “Palës për Mbështetje/Autoriteti kontraktues ” dhe nga ana tjetër (ii) Prodhuesi (BRE) në cilësinë e “Shitësit/Zhvilluesit”.
- Draft Kontrata për diferencë ka për qëllimin të përcaktojë kushtet e përgjithshme që synojnë rregullimin e marrëdhënieve juridike/financiare që lidhen me: (i) projektimin, (ii) financimin, (iii) ndërtimin, (iv) funksionimin (v) garancitë dhe (vi) mirëmbajtjen e centralit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme (BRE) me një kapacitet të instaluar specifik dhe që do të kenë vendndodhjen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e kushteve të përgjithshme të Kontratës për Diferencë.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola SADUSHI